



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 24.2.2025

Nr: 146

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE LËVIZJA BASHKË ME  
KRYETAR Z. ARLIND QORI, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR  
ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 24.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1056 prot., datë 17.2.2025, me:

**KËRKUES:** Partia politike Lëvizja Bashkë, me kryetar z. Arlind Qori

**OBJEKTI:** Regjistrimi i partisë politike Lëvizja Bashkë, si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025

**BAZA LIGJORE:** Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Partia Lëvizja Bashkë nëpërmjet Kryetarit, z. Arlind Qori, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Data: 24.2.2025 Nr:146  
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Lëvizja Bashkë, me Kryetar z. Arlind Qori për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, datë 27.1.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia Lëvizja Bashkë, me iniciale “Bashkë”, me Kryetar z. Arlind Qori, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është Lëvizja Bashkë me shkronja nistore “Bashkë”, me adresë: Rruga “Islam Petrela”, nr. 92, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Arlind Qori, me adresë Rruga “Pjetër Budi”, Pll. 62, Shk. 3, Ap. 36, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Xhuliano Bregasi, me adresë: Rruga “Islam Petrela”, nr. 92, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në, është zj. Vitori Çipi, me adresë: Rruga “Islam Petrela”, nr. 92, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia Lëvizja Bashkë respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia Lëvizja Bashkë, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025”.

## V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike Lëvizja Bashkë, me kryetar z. Arlind Qori, me shkronjat nistore “Bashkë”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**